

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA TREGTARE "DUDA" Sh.p.k NUIS J61825100L



VENDIM

Nr. 01, datë 30.05.2016

Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "DUDA" Sh.p.k

Sot, në Tiranë, më datën 30.05.2016, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "DUDA" Sh.p.k, z. Gafur Dudaj, pasi shqyrtoj Statutin e Shoqërisë dhe bazuar në Nenet 73 dhe 75 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar,

VENDOSI :

1. Miratimin **kalimit të 51 % të kuotës** pjesë e kapitalit të shoqërisë "DUDA" sh.p.k me NUIS J61825100L e shprehur në vlerë në para, në masën **130.369.434,42 lekë.**, nga z. Gafur Dudaj, në cilësinë e palës dhuruese, në favor të z. Besnik Dudaj, në cilësinë e palës pranuese të dhurimit..
2. Shoqëria do të ketë 2 (dy) kuota dhe 2 (dy) ortakë: z. *Gafur Dudaj* me 1 (një) kuotë me pjesë në kapital prej **49 %**, me vlerë **125.256.907,58 lekë** dhe z. *Besnik Dudaj* me 1 (një) kuotë me pjesë në kapital prej **51 %**, me vlerë **130.369.434,42 lekë.**
3. Ngarkohet Ortaku i Vetëm i shoqërisë z. Gafur Dudaj, për zbatimin e këtij vendimi, duke ndjekur procedurat përkatëse të regjistrimit të këtij vendimi sipas *Nenet 74 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar* dhe *Neneve 26, pika 3 dhe 43, pika 3, gërma 'e' të Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar.*
4. Ky vendim hartohet në gjuhën shqipe, në 4 kopje me vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETËM DHE ADMINISTRATORI I SHOQËRISË "DUDA" Sh.p.k

z. Gafur DUDAJ

Gafur Dudaj





DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE
ANISA K. MUSKAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 20 Rep.

VERTETIM NENSHKRIMI

Në Tiranë, sot me datë 01.06.2016 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë), para meje noteres publike Anisa K. Muskaaj, me seli në adresen: Blv: "Bajram Curri" Pallatet "1 Maji", Kati 1, Zyra Nr.2 Tiranë, u paraqitën personalisht shtetasit:

Gafur Dudaj - i biri i Feriatit, i datëlindjes 25.01.1939, lindur në Gumenicë, Vlorë, banues në Tiranë, identifikuar me leternjoftimin Nr. 024407944, Nr.Personal D90125077P, lëshuar më datë 16.02.2009, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.

Personi i mësipërm me vullnet të lirë e të plotë deklaroi se sa më sipër është "Vendimi Nr.1, date 30.05.2016 i Ortakut të vetëm të Shoqërisë "DUDA" shpk i cili është përpiluar jashtë kësaj zyre noteriale dhe nënshkruhet rregullisht prej tij në praninë time.

Përsa më sipër, bazuar në nenin 55 të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë", i ndryshuar, unë noterja vërtetoj nënshkrimin e personave mësipërm konform ligjit.



NOTERE
Anisa K. Muskaaj

Anisa K. Muskaaj
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA TREGTARE "DUDA" Sh.p.k NUIS J61825100L

KONTRATË DHURIMI

Sot, në Tiranë, më datën **30.05.2016**, lidhet kjo Kontratë Dhurimi, midis Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "DUDA" Sh.p.k, z. **Gafur Dudaj**, në cilësinë e **dhuruesit** dhe z. **Besnik Dudaj**, në cilësinë e **pranuesit të dhurimit**, referuar të dyve si "palë kontraktore" dhe secilit prej tyre si "palë", të cilët bien dakort në hartimin e kësaj kontrate sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1 – Qëllimi

Qëllimi i kësaj kontrate është **kalimi i 51 % të kuotës** pjesë e kapitalit të shoqërisë "DUDA" sh.p.k me NUIS J61825100L e shprehur në vlerë në para, në masën **130.369.434,42 lekë**, pa shpërblim për shkak të marrëdhënieve të veçanta midis palëve kontraktore, nga z. Gafur Dudaj, në cilësinë e palës dhuruese, në favor të z. Besnik Dudaj, në cilësinë e palës pranuese të dhurimit.

Neni 2 – Objekti

Objekt i kësaj kontrate është **kuota e vetme**, e zotëruar nga Ortaku i Vetëm, z. Gafur Dudaj, që përbëhet nga vlera e kapitalit në para prej **255.626.342,00 lekë**.

Neni 3 – Baza Ligjore

Kjo Kontratë Dhurimi bazohet plotësisht në Nenin 761 e vijues të Kodit Civil (Dhurimi) dhe në Nenet 73, 74 dhe 75 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, si edhe në Nenet 26 dhe 43 të Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar/

Neni 4 – Të drejtat/detyrimet e dhuruesit

Dhuruesi garanton palën tjetër kontraktore në lidhje me pronësinë me pjesëmarrje 100 % të kuotës së vetme të shoqërisë "DUDA" sh.p.k.

Dhuruesi shpreh vullnetin e tij të lirë dhe të pavesuar për kalimin e **51 % të kuotës** pjesë e kapitalit të shoqërisë ose e shprehur në vlerë në para, në masën **130.369.434,42 lekë**.

Dhuruesit i mbetet një kuotë me pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në masën **49 %** ose e shprehur në vlerë në para, në masën **125.256.907,58 lekë**.



Dhuruesi merr përsipër të kryejë të gjitha formalitetet e regjistrimit të kësaj kontrate dhurimi në regjistrat publik përkatës të regjistrimit të kuotave të shoqërive tregtare, sipas legjislacionit në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Neni 5 – Të drejtat/detyrimet e pranuesit të dhurimit

Pranuesi i dhurimit pranon të përfitojë nga dhurimi duke pranuar dhurimin **kalimi i 51 % të kuotës** pjesë e kapitalit të shoqërisë “DUDA” sh.p.k me NUIS J61825100L e shprehur në vlerë në para, në masën **130.369.434,42 lekë**

Neni 6 – Lidhja e veçantë mes palëve kontraktore

Dhuruesi, z. Gafur Dudaj, dhe pranuesi i dhurimit, z. Besnik Dudaj, janë në lidhje të veçantë familjare mes tyre, ku dhuruesi është babai i pranuesit të dhurimit dhe pranuesi i dhurimit është djali i dhuruesit.

Kjo lidhje e veçantë familjare dhe marrëdhënia e afërt mes palëve kontraktore është thelbi dhe shtysa kryesore në hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate dhurimi nga palët kontraktore.

Neni 7 – Momenti i nënshkrimit

Palët kontraktore bien dakort që momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate dhurimi është data e shënuar në pjesën hyrëse të kësaj kontrate.


Neni 8 – Hyrja në fuqi

Kjo kontratë dhurimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët kontraktore sipas Nenit 7 të mësipërm dhe prej këtij momenti konsiderohet me vlefshmëri të plotë ligjore, duke mos u kushtëzuar nga kryerja e formaliteteve të ndyshme me efekt deklarativ, siç është regjistrimi në organin kompetent të regjistrimit të kuotave të shoqërive tregtare sipas legjislacionit në fuqi.

PALËT KONTRAKTORE

DHURUESI

z. Gafur DUDAJ



PRANUESI I DHURIMIT

z. Besnik DUDAJ

